REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 307/20
Datë/Datum. 02.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Bibaj – Ekspert shqyrtues	26.05.2020	02.06.2020	**307/20**
Kreshnik Spahiu – Ekspert teknik			
	Data e autorizimit të ekspertit	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.05.2020, grupi i OE; NTSHM "Letamed" dhe NTSH "Atommed", me seli në Suharekë kanë parashtruar ankesë me numër 307/20 në OSHP, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK), ku është rekomanduar për kontratë OE "Interlab"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME PAISJE MJEKËSORE PËR LABORATOR PËR NEVOJA TË QKMF- së" me nr. të prokurimit: 623-20-1051-121, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal - Rahovec.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 20,350.00 €.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 4.1 i RRUOPP
Neni 4.4 i RRUOPP
Neni 41.3 i RRUOPP
Neni 41.5 i RRUOPP

Deklaratë mbi faktet dhe argumentet

Te nderuar, për aktivitetin ne fjalë, në me dt. 05.05.2020 jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues Kuvendi Komunal Rahovec, duke e rekomanduar për dhënie te kontratës OE "Interlab" SH.P.K.
Pas këtij vendimi te AK-se, Ne kemi kërkuar qasje ne Dokumente Publike, me qëllim që të bëhet verifikimi dhe vërtetësia së Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës ne baze te Katalogut te prezantuar, a i plotëson specifikat e parashtruara nga AK për këtë pajisje.
Pas lejimit te qasjes nga AK ne kemi verifikuar se Pajisja e prezantuar nga OE "Interlab" SH.P.K i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk i përmbush specifikat e parashtruara nga AK dhe është i papërgjegjshëm.
Me këtë rast, Komuna e Rahovecit ka bërë shkelje të dispozitave të prokurimit publik, konkretisht nenit 41.5 te RRUOPP, 1 cili citon: "Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:
a. është ne pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
b. është ne pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;
c. është dorëzuar nga operatori ekonomik qe përmbush kriteret e përzgjedhjes te përcaktuara ne dosje te tenderit.
Po ashtu, dhënia e kontratës nuk është bere në pajtim rigoroz me vlerësimin e kryer sipas 7 parimeve të cekura në nenin 41.3 të RRUOPP.
Shih tabelën me pozicionet e kërkuara, te cilat nuk i plotëson kjo pajisje:

Nr. i pozicionit	Specifikat për aparat automatik biokimi te parashtruara nga AK	Mos plotësimi i specifikave nga Pajisja e ofruar nga OE fitues
2	Dy krahë punues, një për serum dhe një për reagjent për siguri me te madhe nga kontaminimet	**Nuk e plotëson,** sepse, përdor 1 krah për serum dhe regjent, krahun e dyte e ka vetëm për kivet inkubuse
7	Rotori i mostrave/kalibratoreve/kontrollave te përmbaj jo me pake se 60 pozicione, te gjitha mostrat te kalojnë neper barkod lexues për transferim te te dhënave.	**Nuk i plotëson,** sepse, ka vetëm 39 pozicione
9	Sasia e mostrës nga **1 ul** deri 30ul maximum për një test	**Nuk i plotëson,** sepse, sasia e mostrës nuk fillon nga **1 ul** por është nga 2-70
15	Aparati te ketë kompjuter te integruar ne pajisje (All in One) pa shtëpizë te veçante por te integruar ne monitor . Ekran me prekje min. 15inch, Tankun e ujit dhe te mbeturinave mbrenda njesisë së analyzerit. Aparati duhet te jete BenchTop të vendoset mbi tavoline	**Nuk i plotëson,** sepse, nuk ka kompjuter të integrun ne pajisje. Posedon kompjuter të jashtëm
17	Te ketë te integruar sisteme te teknologjisë nga këto lloje te elektrodave: Elektroda me microprocessor, Flow-cell elektroda apo elektroda te thata	**Nuk i plotëson,** sepse, nuk i posedon 3 nga llojet e elektrodave si ne kërkesë, ka matje vetëm me direkt potentiometry
18	Elektroda te jene me jetëgjatësi se paku 2 vjeçare. Elektroda pa mbushje me filler solution	**Nuk i plotëson,** sepse, posedon elektroda me mbushje

Pas analizimit dhe verifikimit se kjo pajisje nuk i plotëson 6 prej 18 pozicioneve të kërkuara, ne menjëherë me dt. 08.05.2020, kemi parashtruar Kërkesën tone për ri-shqyrtim tek AK Komuna Rahovec me pretendimin se pajisja e ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk i plotëson specifikat e kërkuara nga AK.

AK me dt. 13.05.2020, pretendimit tone e hedh si të pabazuar duke e lënë ne fuqi njoftimin mbi vendimin e AK-së.

Me këtë veprim të papërgjegjshëm te AK-se, ata do te furnizohen me një aparat qe nuk është shume funksional dhe qe nuk do t'i plotësonte nevojat e njësisë se kërkesës. Për shkak se jemi te bindur por edhe ligjërisht sipas dispozitave te prokurimit publik, njësia e kërkesës është ajo qe harton specifikimin teknik dhe këtë duhet ta beje ne baze te një hulumtimi te bere mbi nevojat e tyre, andaj, edhe ka parashtruar qe çfarë specifika teknik kjo pajisje duhet ti përmbaj.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me larte rezulton se Komuna e Rahovecit ka bere shkelje te dispozitave te prokurimit publik gjate ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve, duke mos e bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-se.

Ne i shprehim shqetësimet tona se duke përzgjedh OE qe tenderët e tyre nuk i përmbajnë te gjitha specifikimet e parashtruara nga AK, atëherë, këtu kemi diskriminim dhe favorizim.

Andaj, është e padrejte qe te bëhen te gjitha këto diskriminime dhe këto padrejtësi ndaj OE nga ana e AK-ve, përkundër shume dispozita te prokurimit publik qe i ndalojnë këto dukuri negative.

Neni 4.1 i RRUOPP-se, citon "AK gjatë udhëheqjes se procedurave te prokurimit janë te obliguar te marrin masa te nevojshme për te siguruar trajtim te barabarte dhe jo-diskriminim ne mesin e Operatoreve Ekonomik."

Po ashtu edhe me nenin 4.4 te RRUOPP e obligon autoritetin kontraktues qe me Drejtësi/Mos-diskriminim - Te veprohet ne mënyrë te drejte gjate tere ciklit te prokurimit pa imponuar obligime te panevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesit potencial.

Te shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues te caktuar ose furnizues potencial.

Lidhur me këto parregullsi, Komuna e Rahovecit, përveç shkeljeve te lartpërmendura, ka bere edhe shkelje tjera te këtyre dispozitave te prokurimit publik, e te cilat janë:

Neni 1 i LPP-se, ju obligon qe te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove duke përcaktuar kushtet dhe rregullat qe do te zbatohen, procedurat qe do te ndiqen, te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet qe do te përmbushen nga personat, operatoret ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesioneret e punëve dhe organet publike qe zhvillojnë, përfshihen, marrin pjese ose interesohen, ne aktivitetet e prokurimit ose qe përfshihen ose kane te bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 i LPP-se. Komunën e Prizrenit e obligon qe te siguron qe fondet publike dhe burimet publike te përdorën ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marre ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit. Dhe jo te veprohet ne këtë mënyrë dhe te dëmtoni buxhetin. Ngase blerja e një pajisje qe nuk i plotëson nevojat, mund te jete shkak i asaj qe mos te jete edhe e përdorshme.

Neni 7 i LPP-se, Është parimi baze i Prokurimit Publik, ku ceke se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtoje operatoret ekonomik ne mënyrë te barabarte dhe jo- diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente. Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk do te ekzekutoje asnjë aspekt te aktivitetit te prokurimit ne një mënyrë qe redukton apo eliminon konkurrencën ne mes te operatoreve ekonomik ose qe diskriminon ne dem ose ne te mire të një ose me shumë operatoreve ekonomik.

Duke pasur parasysh argumentet dhe faktet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP qe te merr:

VENDIM

APROVOHET: Ankesa e Grupit te Operatorëve Ekonomik NTSHM "Letamed" dhe NTSH "AtomMed"
ANULOHET: ky aktivitet i prokurimit.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta me pretendimet e kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni Vlerësues pas vlerësimit të tenderit konstaton se Operatori Ekonomik: "Inlerlab" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, i plotëson kushtet e cekura ne Dosjen e Tenderit dhe është Tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Komisioni ne përbërje të plotë rekomandon që tenderi ti besohet kësaj kompanie.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË NTSHM "Letamed" dhe NTSH "Atom-Med"

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues - Komuna e Rahovecit, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të mesme. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës grupi i OE NTSHM "Letamed" dhe NTSH "Atom-Med", me datën 08.05.2020, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK, me pretendimet e njëjta ankimore si në OSHP, përderisa AK, me datën 13.05.2020, përmes vendimit, ka refuzuar kërkesën si të pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor : Eksperti teknik sqaron se OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk plotëson kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit, përkatësisht ankesin 1-specifikimet teknike të detyrueshme në 6 pozicione. Sqarimet janë dhënë në vijim:

a) Në kërkesën numër 7, të specifikimeve teknike, është kërkuar, që Rotori i mostrave /kalibratoreve/ kontrollave te përmbaj jo me pake se 60 pozicione, të gjitha mostrat të kalojnë neper barkod lexues për transferim te te dhënave. Sipas katalogut të produktit të ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë, Response 920, është specifikuar që trau i mostrave apo Sample tray: "*30 positions for bar coded patient samples including STAT positions, 9 positions for blanks, calibrators, controls or samples without bar code and ISE solutions*".
b) Në kërkesën numër 9, të specifikimeve teknike, është kërkuar që sasia e mostrës të jetë nga 1- 30μL[1] maximum për një test. Sipas katalogut, sasia apo vëllimi i mostrës është prej 2 - 70 μL.
c) Në kërkesën numër 15, të specifikimeve teknike, AK ka kërkuar që .... "*Aparati te ketë kompjuter te integruar ne pajisje (All in One) pa shtëpizë te veçante por te integruar ne monitor. Ekran me prekje min. 15inch.....*".

   Në katalogun e produktit të ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë, bazuar në specifikimet e përshkruara dhe imazhet e paraqitura nuk ka të dhëna që pajisja ka të integruar kompjuterë All-in-one dhe ekran me prekje së paku 15 inch. E vetmja e dhënë është e interfejsit, ku specifikohet se pajisja ka mundësi të lidhjes me kompjuter që kanë procesor Pentium IV ose më lartë, përmes "USB connectivity bi-directional".

Sikurse është sqaruar në pikat e mësipërme, produkti i ofertuar nuk përmbush kërkesat e specifikuara nga AK. Bazuar në Nenin 59 të LPP-së, paragrafi 4, ku thuhet "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.....* ", sqarojmë se nuk janë plotësuar kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit.

Ndërsa, lidhur me pikat tjera për të cilat nuk ka informatë në katalogun e dorëzuar, sqarojmë se AK në njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional ka parashtruar kërkesën numër 5- *Prezantimi i produkteve të ofruara me katalogë broshura,* dhe dëshminë dokumentare 5. *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë, tek AK katalogë/broshura nga prodhuesi i këtyre furnizimeve për produkte të ofruar duke e*

[1] Një mikroliter (simboli: μL) është një njësi e vëllimit në sistemin metrik.

nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike. Në broshurën apo katalogun e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, për produktin e ofertuar Response 920, nuk ka përshkrim të karakteristikave sikurse janë kërkuar në specifikimet teknike. Në një rast të tillë, Neni 39. Sqarimi i Tenderëve, i RRUOPP-së, e sqaron si në vijim: "*Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara*" atëherë "*Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm*".

MENDIMI I EKSPERTIT TEKNIK

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe rekomandon që aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Kuvendi Komunal Rahovec
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - NTSHM "Letamed" dhe NTSH "Atom-Med", Suharekë